
Individi

Ca më parë, ca më vonë tërë fshati hyri në kooperativë. Emri i gjatë, me dy *o* si të mos soste njëra, u vriste veshin, mezi e përtypën. Nuk u pëlqyen as fjalë të tjera të huaja, asamble, brigadë, emulacion që zunë rrënjë si ato shkorretet mezhdave të fshatit. Murat Kajaçka ndenji më vete, individ. Kishte qenë partizan gjer në fund të luftës, jo dosido, po komandant skuadre. Menduan se e pati rregulluar me të mëdhenjtë e rrethit, por ai as donte ta përmendte atë kohë.

- Përzumë hasmin e huaj, - mund t'i nxirrje me zor.

Takimeve me nxënësit si ish partizan u shmangej. Mësuesja e djalit gati e bindi, megjithatë nuk shkoi.

- Pata sëmurë lopën, - dredhoi.

Gojët e liga lllapnin se qe bërë pishman për punën e kësaj kooperativës pas lufte. Ai nuk ua vinte veshin. Sa për kooperativën kishte mendimin e vet të palëkundur.

- Vullnetare, - thoshte, - të bëhet mirë hyn, s'të bëhet nuk hyn. Mua nuk më bëhet mirë. Kur i viheshin me argumente të forta, shkonte ca më tej.

- Kam frikë mos më dalin fjalë.

Gruan e ndau tre vjet më parë, jetonte fillikat me djalin e madh.

- S'ishte për të qenë, - përgjigjej po ta pyesje.

Si pinte ndonjë gotë, shtonte nëpër dhëmbë.

- As hundët s'fshinte, shtëpia qelbej. Ç'e desha!

Gruaja e tij ishte zonjë, po ai... Ku mbahej burrë gërnjar si Murati. E rrahu aq, sa mbeti sakate. Gjyqi ia dha dy djemtë, ajo mbajti të voglin.

- Nuk i ushqej dot dy gojë - i tha gjykatësit me lot në sy.

Në valën e ngritjes së kooperativës Muratin e shpunë para komisionit lokal të kolektivizimit. Kryetari, shumë i ri për atë barrë hijerëndë, i kërkoi të bashkohej me të tjerët.

- Është direktivë, - u përpoq t'i mbushte mendjen.

- E di, - i tha dhe u vrenjt:

"Dreq, ç'u pjell mendja, direktivë!"

- Atëherë?

- Me baza vullnetare, kush do hyn, kush nuk do s'hyn.

- S'je më i mirë se të tjerët.

- Domosdo, ka më të mirë, ka më të këqij.

- Po bëhesh pengesë.

- Secili me mendjen e vet.

- S'e ke mirë, - ngriti zërin.

- I zoti e di ku i pikon çatia, - ia ktheu qetësisht.

I deleguari humbi durimin.

- Unë të lidh!

- Lidhmë, - tha Murati.

Kryetari i komisionit lokal urdhëroi t'i vinin prangat. U bind pa fjalë, duarlidhur u paraqit në lokalitet te kryetari i komisionit të rrethit, burrë trupmadh e kockanjar që vinte në këtë detyrë nga lufta, pasi pati kryer me sukses të tjera më pak të rëndësishme se krijimi i kooperativave bujqësore.

- Murat, po ti?

- Më lidhi ky shoku yt, - nuk i ngriti sytë.

- Çne kjo marrëzi!? - u habit.

E kishte pasur komandant, e njihte trim, të besës.

- Kundërshton të hyjë në kooperativë, - raportoï kryetari buzëqumësht i komisionit lokal.

- Hajvan! - e shau kryetari i rrethit, - lirojeni!

Kureshtarët bënë sehir burrin e çuditshëm me duar të lidhura, shumë syresh qeshnin.

U afruan ta zgjidhnin, ai refuzoi.

- Më çoni kështu në Komitet!

- S'është nevoja, - u përpoq ta bindte kryetari i rrethit.

- Është! - ngriti zërin për herë të parë, - ikën ky, vjen tjetër. Të mësohen, kooperativa është vullnetare, kush do hyn, kush s'do nuk hyn.

Qysh atëherë mbeti individ.

Kryetarin e komisionit lokal e shkarkuan, më vonë e burgosën për shkelje të parimit vullnetar në krijimin e kooperativave bujqësore.

Kur e thirrën dëshmitar, Murati e mbrojti.

- Mos i vini faj djalit, aq dinte, aq bëri.

Vështirë të harrohej fytyra e tij stoike, që ia fshihte aq mrekullisht emocionet. I shkurtër e i fortë, supe të ngritur, sy të mëdhenj pa ngjyrë, dimër e verë i fuste xhaketës krahun e djathtë, të majtin e mbante zhveshur. Flokët e zbërdhulur nuk u thinjën, as i ranë, kapa e kadifesë rrasur mbi sy i jepte fytyrës rrumbullake pamje tallëse. E veçanta e tij qenë buzët e përveshura. E poshtmjia, më e përveshur se e sipërmja, e tregonte përherë buzagaz, zor ta kuptoje ishte i mërziur a i gëzuar.

Fshatarët e donin. E donin dhe u vinte keq, se ishte individ, pa grua, më mirë të hynte në kooperativë si të gjithë.

- Çdo të bëjë kooperativa, më marton dot në këtë moshë? - qeshte.

Buza e poshtme i përvishej më shumë.

- Sidoqoftë, me shokë, - i thoshin.

- Me shokë, po qesja veç.

Kishte nga ata që e shikonin vëngër. Ai s'e prishte terezinë, i respektonte të gjithë, pa dallim.

Vështirë të haheshe me të, për çdo gjë përgjigjen e kishte majë gjuhës. Nuk shante, as mërziutej, ta mbushte mendjen urtë e butë. Filozofia e tij e thjeshtë përmbledhej në pesë fjalë:

“Mos bjer kurrë në duart e të tjerëve!”

Ia kishte ënda të debatonte sidomos në prani të njerëzve. Të deleguarit duronin sa duronin, shpërthenin, bëheshin qesharakë.

Propaganda ngritur me mundim thërrmohej.

Operativi i zonës krijonte situata të besueshme, ku patën rënë burra jo aq mendjehetë, sidomos nga të prekurit.

Ai e kishte këtë cen si individ.

- Rrëmujë kjo kooperativa, - i tha çehrevrenjtur.
- Pse? - e pyeti.
- S'e merr vesh i pari të dytin.
- Duhet ta diskutosh me anëtarët e kooperativës, unë s'kam si ta di, jam individ.
- E shikon si venë punët.
- Për sa shoh duket ajar.
- Ç'dreqin kërkon të thuash? - pyeti me paramendim.
- U bëhej mirë pa hynë, ndryshe pse do të hynin?

Sado u përpoq, në fjalët e burrit qesharak me buzë të përveshura, kapën çapraz mbi kokë nuk gjeti asgjë kundër kooperativës.

- Delen e veçuar e ha ujku, - e këshilloi një mbrëmje Hekurani, të cilën e respektonte se qe i drejtë, pa hile.

- Është vullnetare, - ia ktheu buzagaz, - ty të bëhet mirë, mua jo.
- Lëri ore përçartjet, nuk je në mbledhje këtu!

Qeshi, mbushi çibukun, e ndezi.

- Kooperativa s'është për ne, Hekuran. Shkoj në arë kur dua, kthehem si mbaroj punë, purtekën s'e kam qejf, as urdhrat. Në luftë qe ndryshe. Pa ndërlihdje, pa marrëveshje nuk shporrej i huaji. Tani përse?

Lufta i dhembte, tëra ata të vrarë!

- E kanë harruar, as e zënë në gojë.

Sakaq u pendua.

- E di, nuk më nxjerr fjalë, - i tha.

Hekurani e shikoi me inat.

- E de, se thashë nuk të rashë. Me që ra fjala si je me ekonominë ti?
- Njëfarësoj, - s'e bëri veten, - ka më keq.
- Këtë dimër u kam dhënë bereqet disave.
- Epo, punon vetë, merr vetë.
- Aty ta kam.

- Mirë o mirë, po nuk i bihet murit me kokë.

- Si ta vërtitësh.

Ndaloi pak të ndizte çibukun.

- E di atë historinë e dhenve ti?
 - Ku e ke fjalën?
-

- Tre barinj lidhën shoqëri. Puna u ecte, gjë e gjallë shtoej, bulmeti po ashtu. Njërit i vajti mendja të bashkonin tufat, të ndanin prodhimin barabar.

Ngriti kokën, i kërkoi sytë.

- Si puna e kësaj kooperativës, - qeshi, buza e përveshur iu mbush me pështymë.

Hekurani u vrenjt,

Ai nuk ngurroi ta shpinte gjer në fund historinë.

- E gjetën me vend kërkesën, u bashkuan. Kaloi ndonjë vit e pak, hyri hilja. I shmangeshin punës, nuk e kërkonin kullotën, ia kalonin barrën njëri-tjetrit tjetrit. Prodhimi ra, bagëtia firoi, shkurt rrokullimë.

“Gjënë e përbashkët e dhjeftë qeni!” - mallkuan.

Ndanë ç’u mbeti. U desh kohë të arrinin derexhenë e mëparshme, të ujdin atë që prishën me duart e tyre.

- Këput ca të trasha ti!

- E solli rasti.

- Të shkurtojnë gjuhën për gjëra të tilla.

Hekurani u ngrit, iku.

Propaganda e quante patriarkal, reaksionar, nofkën *individ* ia thoshin me përbuzje, si bie fjala kurvar apo hajdut. Ai s’e prishte terezinë, bënte sikur s’kuptonte.

Me të rënë çanga kooperativistët shkonin arave, bënin shaka, mbanin nëpër gojë njerëzinë. Fillonin e mbaronin me urdhër, pushonin me urdhër.

Murati nxirrte nga ahuri qetë, kalin, merrte djalin për dore nisej me nge. I dilte vetë për zot punës, fishkëllente, këndonte, fliste me qetë, të birin.

- Ne e kemi mirë apo ata? - pyeste.

- S’e di, - përgjigjej vogëlushi, - shokët më shajnë.

- Si të shajnë?

- *Individ*.

- Punë e madhe, kanë gjë të gjallë ata?

- Kanë, po i mbajmë stallave.

- Stallat janë të kooperativës.

Djali ngrinte supet.

- Duro ca e do të shohësh!

Kooperativën nuk e honepste për mbledhjet e shpeshta, çangën tri herë në ditë, urdhrat poshtë e lart, fukarallëkun.

Sidomos këtë.

- Ku do të punosh nesër? - e pyeti një mbrëmje Hekuranin.

- Ku të na dërgojë Konia.

Kone i thoshin brigadierit me zërin e fortë e të hollë prej gruaje, që nga larg vinte si e lehur këlyshi.

- Konia s’ka pasur tokë e bagëti, ku e di radhën e punës?

- E po, brigadier hesapi.

- Vetë e zgjodhët, - u zgërdhi.

Hekurani nuk duroi më

- Kujt i shkoi mendja për këtë budallallëk xhanëm, janë bërë njerëzit të flasin me vete.

I pati vajtur majë hundës, në djall të vinte, më keq se aq!

- Paske qenë i mençur! - i tha.

- Pse?

- Ja de, nuk hyre në kooperativë.

- Me zor nuk të futën, t'u bë mirë pa hyre, mua nuk m'u bë mirë.

- Tani s'dal dot se!

Qeshi për herë të parë me përçartjen e individit Murat Kajaçka.
